Nr._____Prot Shkodër, më ___.___.2026

Në përgjigje të kërkesës për informacion, mbi aktivitetin e Teatrit Migjeni për periudhën 2021-2026, ju sqarojmë që Bashkia Shkodër për të siguruar transparencën ka të publikuar në faqen zyrtare web të gjithë informacionin që është objekt i kësaj kërkese. Mund të aksesoni lehtësish në faqen web ne rubrikën Buxheti, "Raportime Monitorimi", veprimtarinë e Teatrit, të ardhurat e gjeneruara dhe ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve të godinës.

Më poshtë gjeni linqet përkatëse, ku mund të aksesoni informacionin e kërkuar, si dhe nje informacion të përmbledhur te aktiviteteve kryesore për periudhën e kërkuar:

Realizimi i aktiviteteve per vitin 2021:

https://bashkiashkoder.gov.al///wp-content/uploads/2023/09/relacion_monitorimit_te_buxhetit_2021_4891.pdf

Realizimi I te ardhurave:

III.1.11.3 Teatri "Migjeni" 679. 000 leke

Fishe proijekti P08220.O3.A12: Pjese Teatrore 1 "Black Box/ Kutia e zezë" u shfaq me datën 5 dhe 6 nëntor 2021, e adaptuar për skenë nga Fatos Berisha e "Perfect Strangers" e Paolo Genovese.

Fishe P08220.O3.A13: Pjesë Teatrore 2- Situata e pandemisë përcaktoi një qasje të re të trupës së teatrit Migjeni. Ato organizuan një festival teatror me performancë në ambjente të jashtme të qytetit gjashtë shfaqje teatrore "KOLIQIANA" në ambjente të hapura të qytetit tonë. Shfaqja e parë: "A TA LAÇË"- Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Krist Lleshi, Linda Jarani. Interpretuan: Fritz Selmani, Lusi Bregu, Silvia Kacarosi, Arber Bala, Anrida Lopçi. Shfaqja e dytë:

"ANMIKU NË SHTËPI" - Dramatizuar dhe vënë në skenë nga: Fritz Selmani. Interpretuan: Simon Shkreli, Rezarta Smaja, Nikolin Ferketa, Sara Prençi, Aleksandër Prenga, Antonio Shllaku. Shfaqja e tretë nga "KOPSHTI"- Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Vladimir Doda. Interpretuan: Rajmonda Marku, Nikolin Ferketa, Luelda Stani, Ester Hysenaj, Ardit Ramaj. Shfaqja e katërt: "TINGËLLIMET", Teatër poetik - Konceptuar dhe vënë në skenë nga Rajmonda Marku. Interpretuan: Astrit Fani, Vladimir Doda, Rajmonda Marku, Granit Halili, Marsela Mjeda, Marko Prendi.

Shfaqja e pestë: "E GJETI MBAS SHIMSHIRIT"- Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Merita Smaja. Interpretuan: Muhamir Saiti, Niki Mjeda, Jursi Temali. Shfaqja përmbyllëse e Festivalit

teatror "KOLIQIANA" ishte me "TREGTAR FLAMUJSH" Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Jozef Shiroka. Interpretuan: Astrit Fani, Fritz Selmani, Jozef Shiroka.

P08220.O3.A13: Pjesë Teatrore 3 Per shkak te pandemise, renies se numrit te spektatoreve ne sallen e teatrit, që nga datat 21- 26 Qershor, "Koliqiana" u rikthye në oborret e Shkodrës. Qytetarët shkodranë hapën dyert e shtëpive për "Koliqianën" dhe dashamirësit e artit. Jane realizuar 5 shfaqje ne oborret e familjeve shkodrane.

P08220.O3.A15 : Variete Estrada e Shkodrës u rikthye në skenën e Migjenit, pas një shkëputje gati dy vjeçare. Komedia "Koncert në Kohë pandemie" godet e thumbon kohët që po jetojmë dhe debatin për prindin duke bërë bashkë emra të brezit të artë të humorit me aktorë të rinj. Ismet Drishti rikthehet pas 23 vitesh si regjisor në qytetin e tij duke mbledhur mjeshtërat të mëdhenj: Zef Deda, Besnik Çinari, Drande Xhaj. Përkrah artistevë të medhenj luajtën edhe artistët e rinj të qytetit tonë si: Nikolin Ferketa, Fritz Selmani, Klodiana Vata, Lusi Bregu, Ketlin Pjalmi, Enejda Kruja, Aleksander Prengaj, Arbër Bala, Pëllumb Gjonaj. Estadës nuk i mungoi kënga, mbasi në skenë u ngjitën artistët Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Ketlin Pjalmi, Klodiana Vata. Komedia "Koncert në Kohë pandemie" u shfaq per publikun per 7 netë rradhazi.

P08220.O3.A16: Shfaqje për fëmijë+ Teatri i kukullave Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin. Gjate vitit 2021 teatri i kukullave shfaqi premierat e “Kush e hëngri mjaltin” dhe “Maçok Çamarroku” për disa javë rradhazi, duke mbushur plot oborrin e Teatrit Migjeni.

P08220.O3.A17: Pranverë me këngë Me 28 maj 2021, në oborrin e teatrit Migjeni u zhvillua koncerti “Pranverë me Këngë”. Me një pjesëmarrje të gjërë të publikut, në skenë interpretuan këngëtarët, Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Orjeta Kelaj, Leonard Guga, Blerta Cina, Ylber Tahiri, Leonora Luca, Ademir Fresku, Ketlin Pjalmi, Niki Mjeda, Glerdit Turmetaj, me udhëheqës artistik Ilir Zoga.

Realizimi I aktiviteteve per vitin 2022:

https://bashkiashkoder.gov.al///wp-content/uploads/Relacion-Monitorimi-12-M-2022.pdf

Realizimi i ite ardhurave: III.1.11.3 Teatri “Migjeni” 306. 000 leke.

P08220.O3.A22 Pjesë Teatrore 1

“Zhurma përtej skenës” ishte premiera e rradhës e realizuar nga trupa e Teatrit Migjeni. Me autor Michael Frayn, erdhi e adaptur dhe me rregji nga Enke Fezollari. “Zhurma përtej skenës” solli për publikun prapakenat që ndodhin gjatë një shfaqjeje teatrore, te papriturat, problemet dhe marrdhënien e aktorëve ndërmjet tyre. Interpretuan aktorët: Rita Gjeka Kacarosi, Jozef Shiroka, Simon Shkreli, Krist Lleshi, Merita Smaja, Aleksandër Prenga, Rajmonda Marko, Fritz Selmani, Nikolin Ferketa. Premiera u shfaq për publikun në datat 5,6,7 nëntor 2022.

P08220.O3.A23 Pjesë Teatrore 2 Komedia “Gjaja” Autor Joe Orton dhe me regji të Altin Bashës u vu në skenë me datë 8 Qershor 2022. Kjo shfaqje mori pjesë në festivalin “KOKO Fest” e

Korçë ku u vlersua me 2 çmime, çmimin, ”Regjia më e mirë” Altin Basha dhe çmimin”Aktorja më e mirë protagoniste” Kristi Lleshi .

P08220.O3.A24 Pjesë Teatrore 3 Për herë të parë në sallën e teatrit Migjeni u shfaq një musical, një risi e cila tërhoqi vëmendjen e publikut shkodran. Premiera e re “ Takimi i parë”, frymëzuar nga Austin Ëinsberg, u vu në shkenë nga regjizorja e re shkodrane Ina Morinaj, në datat 21 dhe 22 Dhjetor 2022. Intepretuan e aktorët e Teatrit Migjeni: Jozef Shiroka, Krist Lleshi, Rita Gjeka Kacarosi “Mjeshtër i Madh”, Fritz Selmani, Savjana Vjerdha, Aleksandër Prenga, Nikolin Ferketa.

P08220.O3.A25: Variete Komedia “Big Brother Vip Shkodra” libreti Ismet Drishti, Besnik Çonari. Regjia Ismet Drishti. Morën pjesë 15 aktorë, duhet të theksohet se 10 nga këto ishin të rinj.

P08220.O3.A26: Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin. Këtë vit teatri i kukullave shfaqi premierat “ Pufi dhe Gufi” dhe “Fyelli magjik”.

P08220.O3.A27: Pranverë me këngë. Festivali i këngës popullore shkodrane Festivali “ Prandvere me kange” u zhvillua në datat 20-21 Mars. Në këtë festival u angazhua afro 75 artist, si kompozitor, tekst shkrues, orkestrues, këngëtar, orkestrant dhe prezantues. Ky Festival pati Udhëheqës artistik, Ilir Zogën dhe regjisor: Jozef Shirokën.

P08220.O3.A28: Festival teatri me shkollat e mesme Festivali Teatror i shkollave të mesme u zhvillua në datat: 1-7 Mars. Morën pjesë 6 shkolla. Ato u paraqitën në këtë Festival me 6 tregime të dramatizuara dhe vënë në skenë nga 6 aktorë së trupës së teatrit. U aktivizuan 48 nxënës. Në fund të Festivalit, Juria vlerësoi si shfaqja me e mirë “ Tregtare flamujsh” interpretuar nga nxënësit e shkollës Jordan Misja. U vlersuan si aktorja me e mire, nxënësja e shkollës “28 Nëntori “ dhe si aktorët më të mirë nxënësit e shkollës “P. Jakova” dhe “Sh. Juka”.

Realizimi i aktiviteteve per vitin 2023 te Teatrit Migjeni:

https://bashkiashkoder.gov.al///wp-content/uploads/Permbledhes-relacioni-Monitorimi-12-Mujori-2023.pdf

Realizimi I te ardhurave: III.1.11.3 Teatri “Migjeni”- 2,005 mije leke

Fishe: P08220.Q1.O3.A22.

Pjesë Teatrore 1.– Hekuba e Euripidit, mbi këtë lloj teleturgjie ballkanike autentike, Enke Fezollari dhe grupi i tij na ftojnë të shijojmë një shfaqje multikulturore, përmes këndvështrimit të tyre njerëzor, zakoneve e karakteristikave të tyre, me shtysë traditën e veriut të Shqipërisë. Në shfaqje rolin e Hekubës interpretoi Rita Gjeka Kacarosi. Në këtë shfaqje mori pjesë aktorja e mirënjohur Vefi Redhi, e cila jeton dhe punon në shtetin helen si edhe aktori i madh dhe njëkohësisht Drejtor i Teatrit Shqiptar të Shkupit Adem Karaga. Intepretuan gjithashtu aktorët Jozef Shiroka, Krist Lleshi, Fritz Selmani, Rajmonda Marku, Merita Smaja, Nikolin Ferketa dhe Aleksander Prenga. Këndoi Rezarta Smaja, e shoqëruar nga muzikanti Bledi Doci. Kostumet e

skenografia: Divni Gushta. Premiera “Hekuba” u shfaq me datë 5 maj ne teatrin Migjeni. Shfaqja “Hekuba” mori pjesë edhe në Festivalin Ndërballkanik të dramës në Athinë.

P08220.Q1.O3.A23: Pjesë Teatrore 2 –Vizita – Pemierë absolute në Teatrin Migjeni, mbështetur në kryeveprën e H.G. Wells “Vizita e mrekullueshme”,vënë për herë të parë në skenë nga regjizori italian Davide Iodice, nga trupa e Teatrit Migjeni me datë 27,28,29 Tetor. Shfaqja “Vizita” mori pjesë në konkursin mbarëkombëtar “Festivali teatror Moisiu” i cili u zhvillua në Tiranë në datat 20-27 Nëntor. Një sukses i jashtëzakonshëm, performacë rrënqethëse e aktoreve, u cilësua si shfaqja më e mirë e vivete të fundit të kësaj trupe. Shfaqja “Vizita” u shpall fituese e tre çmimeve në këtë kompeticion mbarëkombëtar: “Shfaqja më e mirë” “Muzika më e mirë” “Skenografia më e mirë” Trupa fituese ishin aktoret: Rita Gjeka Kacarosi, Pjerin Vlashi, Jozef Shiroka,Julinda Emiri, Fritz Selmani, Nikolin Ferketa, Aleksander Prenga, Vladimir Doda, Merita Smaja, Raimonda Marku. Ky projekt erdhi si bashkëpunim mes teatrit Migjeni dhe Insitutit Italian të Kultures dhe Amasada Italiane.

P08220.Q1.O3.A24: Variete “Big Brother Shkodra Vip 2” u rikthye në Shkodër por jo siç jemi mësuar ta shohim si një "Reality Show", por në skenën e Teatrit Migjeni. Komedia u vendos në skenë nga regjizori Arian Çuliqi dhe trupa e aktorëvë të teatrit “Migjeni” si: Fritz Selmani, Keltin Pjalmi, Aleksander Prenga, Nikolin Ferketa, Lusi Bregu,Savjana Vjerdha, Gerti Palali dhe Arber Bala. Nuk i munguan skenës aktoret e medhenj Zyliha Miloti, Besnik Qinari dhe Drande Xhai, duke i dhënë kësaj komendie një sukses të garantuar. Si ne cdo variete, muzika ishte një kompunent i rëndësishëm dhe në “Big Brother Shkodra Vip 2” morën pjesë këngëtarët : Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Ademir Fresku, Glerdit Turmetaj. “Big Brother Shkodra Vip 2” mbushi plot sallën e Teatrit “Migjeni” për 10 netë rradhazi

Me datë 15 Dhjetor 2023, në sallen e Teatrit Migjeni, me rastin e 65 vjetorit estradës profesioniste të Shkodrës u shfaq premiera e dokumentarit “Paulin Preka- Mjeshtri i skenës”, ku morën pjesë rreth 375 spektatorë. Me datë 18 Dhjetor u shfaq premiera e estradës “Gaz paç o moj Shkodër”. Kjo shfaqje u dha 4 harë dhe e ndoqën 1680 spektator.

P08220.Q1.O3.A25: Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin. Këtë vit teatri i kukullave shfaqi “Festa ne pyll” e shkrimtarit Kolec Pepa dhe me regji të Drande Xhaj. Në këtë premiere morën pjesë, 5 aktorë. Premiera u shfaq me 11 dhe 12 Mars . Teatri i kukullave “Festa në pyll” ka vazhduar shfaqjet pe tij edhe gjatë mujit maj dhe qershor, duke dhënë në total 11 shfaqje duke u ndjekur nga 1.226 fëmijë.

P08220.Q1.O3.A27. Pranverë me këngë. Koncerti “Pranverë me këngë” u zhvillua me datë 12 Maj në Teatrin Migjeni. Nën udhëheqjen e Maestro Ilir Zoga, ky koncert shfaqi para publikut një repertor të larmishëm ku përfshinte këngë shqipëtare por edhe të huaja nën interpretimin e artistëve te afirmur dhe të rinj të qyetitit.

P08220.Q1.O3.A27: Festival teatri me shkollat e mesme Festivali Teatror i shkollave të mesme u zhvillua në datat: 20-25 Shkurt. Morën pjesë 6 shkolla. Ato u paraqitën në këtë Festival me 6 tregime të dramatizuara dhe vënë në skenë nga 6 aktorë së trupës së teatrit. U aktivizuan 48 nxënës . Në fund të Festivalit, Juria vlerësoi si shfaqja me e mirë “Riedukimi i Apolonit” interpretuar nga nxënësit e shkollës Jordan Misja.

Realizimi I aktiviteteve per vitin 2024:

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Relacioni-monitorimit-12-M-2024-Bashkia-shkoder.pdf

III.1.11.3 Teatri "Migjeni" 3,363 mije leke.

8220 Instalimi i sistemit të ngrohjes dhe ftohjes Teatri Migjenizbatim, mbikëqyrje, kolaudim

P08220.Q1.O3.A18 Festivali mbarëkombëtar i humorit në shkodër " 11 – 15 Dhjetor 2024 Teatri "Migjeni" realizoi me sukses per 5 nete rradhazi Festivalin Mbarëkombëtar të Humorit. Ky festival ishte një urë lidhëse midis artistëve dhe publikut të trevave shqipfolëse, duke përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe komunitete të tjera shqiptare. Festivali ishte konceptuar në një format dinamik, duke përfshirë workshop-e, diskutime tematike dhe shfaqje të shumëllojshme skenike çdo mbrëmje. Aktivitetet kryesore; Punëtoritë tematike (Ëorkshops): Të mbajtura nga personalitete të njohura të skenës dhe letrave shqiptare si Bujar Kapexhiu, Haxhi Rama, Zija Vukaj dhe Filip Çakuli. Shfaqje Skenike: Përfshirje e 50 artistëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Risi: Prezantimi i filmave të shkurtër humoristikë, duke sjellë një frymë të re dhe moderne në Festival. Aktorët që morën pjësë në edicionin e parë të "Festivali Mbarëkombëtar i Humorit në Shkodër " ishin : Agron Llakaj, Xhevahir Zeneli , Behar Mera, parodistët e vlorës: Afrim Agalliu, Agron Amo, Muharrem Hoxha, Sevdai Radogoshi, Sejfulla Myftari (Cekja) dhe Rexhep Ustaj. Stand-up comedy : Asim Sopi Memishi, Avni Shkodra, Kushtrim Qerimi, Valina Muçolli, Marin Orhanasi, Edi Oga, Akil Varfi, Tan Brahimi, Gent Hazizi dhe Besnik Mustafaj. Aktorët e mirënjohur të estradës së Shkodrës: Zyliha Miloti, Besnik Çinari, Drande Xhaj dhe Edmond Halili. Aktorët e rinjve: Fritz Selmani, Aleksandër Prenga, Nikolin Ferketa, Evis Muriqi, Amelia Krosaj, dhe Lusi Bregu, Gjatë këtyre 5 netëve morën pjese këngëtarët: Mukades Çanga, Laorjan Ejlli, Orjeta Kelaj, Savjana Vjerdha dhe Rrezarta Smaja, të shoqëruar nga orkestra e teatrit "Migjeni". Festivali u moderua nga Savjana Verdha dhe Ketlin Pjalmi.

P08220.Q1.O3.A19 Teatër Kukullash "Mbretëresha e Borës", Teatri "Migjeni" prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin. Teatri "Migjeni" vitin 2024 e ka hapur me një shfaqje dedikuar spektatorit me të mirë, fëmijëve. Me regji të Merita Smajës, me datën 10.02.2024 është shfaqur premierë "Mbretëresha e Borës" e përshtatur nga Shegushe Bebeti dhe me një skenografi me projeksion që vjen për herë të parë në skenën e Teatrit "Migjeni" përgatitur nga Divni Gushta, u interpretua nga Drande Xhaj, Merita Smaja, Astrit Fani, Fritz Selmani dhe Gjovalin Kolaj, e cila u shfaq 12 herë dhe u ndoq prej rreth 3200 fëmijëve.

"Festival Teatri me shkollat e mesme" Shkollat e mesme gjatë këtyre viteve janë përfshirë në disa iniciativa teatrore, siç është edhe projekti "Festival teatri me shkollat e mesme". Në këtë aktivitet u përfshinë disa nga gjimnazet publike dhe jopublike të territorit të Bashkisë Shkodër të cilët nën përkujdesjen e aktorëve të teatrit "Migjeni" gërshetuan interpretimet e veprave te ndryshme. Me datë 11 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme "Jordan Misja" me pjesën "Parathania e Parathanies", me regji nga Jozef Shiroka; Me datë 12 Mars 2024

në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “28 Nëntori” me komedinë “Pallati 176”, me regji nga Fritz Selmani; Me datë 13 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Hamdi Bushati” me pjesën “Sokaku i të marrve” me regji nga Vladimir Doda; Me datë 14 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Adem Haxhija” – Postrribë, me pjesën “Ariu”, me regji nga Simon Shkreli; Me datë 15 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “At Pjetër Meshkalla” me komendinë “ 14 vjeç dhëndërr”, me regji nga Aleksandër Prenga; Me datë 16 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “At Gjon Karma”- Gur i Zi, me pjesën “E djegur për së gjalli”, me regji nga Nikolin Ferketa; Me datë 17 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Shejnaze Juka” me pjesën “Noemi”, me regji nga Gerti Palali; Me datë 18 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Prenkë Jakova” me pjesën “Njohja në internet”, me regji nga Raimonda Marku; Me datë 19 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Oso Kuka” me pjesën “Fëmijët e rrugës”, me regji nga Merita Smaja. Juria e “Festival Teatri me shkollat e mesme” ishte e përbërë nga : Arian Çuliq (Kryetar) , Drande Xhaj, Zija Vukaj, Krist Lleshi dhe Akil Varfi, vleresuan performancat.

Komedia “Krimi është vetëmi imi”, i Autorëve francez George Berr dhe Louis Verneil, erdhi në një variant të përshtatur nga regjisorja Driada Dervishi Jani dhe u vu në skenën e Teatrit Migjeni në datat 11-13-14-15 Shtator 2024. Komedia “Krimi është vetëmi imi” bëri sëbashku aktorët e Teatrit Migjeni si: Pjerin Vlashi, Merita Smaja, Jozef Shiroka, Fritz Selmani, Nikolin Ferketa me aktorët e mirnjohur të skenës shqiptare si: Olta Daku, Neritan Liçaj, Romir Zalla, Rudina Dembacaj, Linda Jarani, me pjesëmarrjen e aktorit te mrekullueshëm Besnik Çinari, të cilët i dhuruan publikut shkodranë një shfaqje komedi të një niveli të lartë artistik. Mjeshtri Zef Çoba kompozoi pjesët muzikore të kësaj shfaqje, të cilat u luajtën nga orkestra e Teatrit Migjeni. Kjo shfaqje mori pjesë në festivalin Mbarëkombëtarë të Komedisë “KOKO Fest”, ku dha shfaqjet e veta duke përfaqësuar Teatrin “Migjeni”, i cili u zhvillua në Korçë. Komedia “Krimi është vetëmi imi” on tour u zhvillua në Tiranë për 3 net rresht në sallën e Universitetit të Arteve në datat 12 dhe 13 tetor 2024. Ndërsa në datat 6 dhe 7 nëntor 2024 komendia u shfaq në Teatrin “Aleksandër Moisiu”.

Shfaqja “Vizita” mori pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove MESS,Sarajevë, në edicionin e tij të 64-t, një festival i kategorisë A. Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove MESS është më i vjetër i teatrit në Ballkan dhe një nga më të mëdhenjtë në Evropën Juglindore.

Opera per tre grosh - Shfaqja “Opera për tre grosh” e Bertolt Brecht, me regji nga Kuniaki Ida, u realizua me sukses në Teatrin “Migjeni”, Shkodër. Një aspekt kyç i kësaj shfaqjeje ishte bashkëpunimi mes aktorëve nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët punuan së bashku me trupën e Teatrit Migjeni. Në skenë morën pjesë gjithsej 14 aktorë. Skenografia e dizajnuar nga Divni Gushta krijoi një atmosferë ekspresive dhe groteske, duke e bërë skenën një pjesë integrale të veprës. Kostumet, të krijuara nga Ilirjane Basha, reflektonin stilin e kohës moderne dhe plotësonin idenë ekspresive të Brecht-it. Grimi grotesk, nën kujdesin e Albert Shirokës, shtoi një dimension të veçantë vizual në transformimin e aktorëve. Ndriçimi i Arben Meshnunit ndihmoi në krijimin e zhvendosjeve ambientale dhe emocionale, ndërsa muzika e përpunuar nga Markelian Kapidani theksoi dramatizmin e situatave skenike. Koreografitë i shtuan një energji të veçantë lëvizjeve dhe performancës së aktorëve.. Aktorët që morën pjesë: Refael Hoxhaj, Bujar Hoxhaj, Merita Smajaj, Zana Berisha, Pjerin Vlashi, Jozef Shiroka, Vladimir Doda, Nikolin

Ferketa, Fritz Selmani, Aleksander Prenga, Vlora Dervishi. Aktorët e rinj: Denisa Luanaj, Evis Muriqi dhe Vitmir Alikokej.

Musical Matilda –

Për herë të parë në skenen e Teatrit Migjeni u realizua një Musical, risi e cila mbushi sallen e teatrit me publikun kryesor, femijët. Shfaqja teatrale muzikore "Matilda", frymëzuar nga kryevepra e Roald Dahl, përqendrohet tek Matilda Ëormëood, një vajzë pesëvjeçare e e cila me dhuntinë e telekinezës, e cila i pëlqen të lexojë, kapërcen pengesat e shkaktuara nga familja dhe shkolla e saj dhe ndihmon mësuesin e saj të rimarrë jetën e saj. E risjellur nga një trupë e talentuar aktorësh të vegjël së bashku me aktorët profesionistë, personazhet e musical Matilda do të mbeten gjatë në mendje. Me koreografinë e Kozeta Bakiut, skenografinë e Divni Gushtës dhe regjinë e Gerti Palalit, shfaqja solli një spektakël emocionues për fëmijët dhe të rriturit. Pjesë e këtij projekti ishte dhe pjesëmarrja e fëmijëve të qendrës kultuore të fëmijëve "Kujtim Alija".

Realizimi I aktiviteteve per vitin 2025:

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Relacioni-permbledhes-Programe-Monitorimi-12-M-2025.pdf

P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim i aktiviteve të Teatrit Migjeni e të trashëguara.

1. Më datë 25 prill 2025, u shfaq komedia teatrale "Kërkohet një Tenor" – një vepër klasike e dramaturgut amerikan Ken Ludëig – realizuar si bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Teatrit Kombëtar. Ky bashkëpunim solli një prodhim skenik të nivelit të lartë, me një kast të përzgjedhur aktorësh dhe profesionistësh të fushës së teatrit, të cilët bënë të mundur një shfaqje dinamike dhe mjaft të mirëpritur nga publiku shkodran. Në këtë shfaqje morën pjesë aktorët: Helidon Fino, Pjerin Vlashi, Genti Deçka, Ilirda Bejleri, Elia Zaharia, Flaura Kureta, Niada Saliasi, Fritz Selmani. Shfaqja u vu në skenë nga regjisori i njohur Armand Bora, Skenograf: Divni Gushta Kostumografe: Laedia Hajdari Përkthyes i veprës: Durim Taçi Dizajn Grafik: Klea Mani Asistent Regjisor: Astiano.

2. Pjesë teatrore 1- "Kërkoj vrasës për nënën", premierë në Teatrin Migjeni. Në Teatrin "Migjeni" me datë 25 dhe 26 maj, u dha premiera e shfaqjes teatrore "Kërkoj Vrasës për Nënën", me autor Ressel Lëts dhe përkthim nga Artur Lena. Regjia e kësaj vepre u realizua me mjeshtëri nga Naser Shatrolli, duke sjellë në skenë një interpretim të fuqishëm dhe të ngarkuar emocionalisht. Në këtë prodhim artistik morën pjesë aktorë të talentuar që dhanë një performancë të shkëlqyer: Ermal Sadiku, Jurgen Marku, Jozef Shiroka, Lusi Bregu, Ina Morina. Asistent regjie: Astrit Fani Skenografia: Naser Shatrolli & Divni Gushta Muzika: Drinor Zymberi Kostumografia: Flutura Dedinaj Krijimi i posterit: Labinot Ibërdemaj Dizajni vizual: Valdet Hajdari Traileri: Dalmat Dobra Figura dhe posterët: Amar Havziji, Fotografia: Rozafa Shpuza.

3. Teatri "Migjeni" organizoi "Festivali Teatror i Shkollave të Mesme", një aktivitet artistik që u zhvillua përgjatë datave 16–19 qershor 2025, me synimin për të promovuar krijimtarinë teatrore të të rinjve dhe për të nxitur shprehjen e lirë artistike ndërmjet gjimnazistëve të qytetit të

Shkodrës. Festivali përfshiu pesë shfaqje teatrore, me pjesëmarrjen e disa prej shkollave të mesme aktive në jetën artistike të qytetit. 16 Qershor 2025 1. “Letër fëmijës së palindur kurrë” – Oriana Fallaci Ora: 13:00 Shkolla: Gjimnazi “Shejnaze Juka” Regjia: Nikolin Ferketa Aktorë: Luciana Thana, Sara Hasanaj, Mateos Gilaj, Leonora Molla, Manuela Ndrezaj, Olkida Lumi, Armena Brahimi, Regisa Mlloa Një interpretim emocional dhe introspektiv i veprës së njohur të Oriana Fallaci, që solli në skenë dilemat njerëzore dhe mesazhe të thella për jetën dhe ekzistencën. 2. “Sëing Mood” – dramatizim me autorë të ndryshëm Ora: 18:00 Shkolla: Gjimnazi “Oso Kuka” Dramatizimi: Kristel Pjetri dhe nxënësit 221 Regjia: Vladimir Doda Aktorë: Denis Dekovi, Iderisa Duhanxhi, Amar Fishta, Angjela Koja, Egli Lulaj, Marinela Mukuri, Arsi Peku, Kledia Pjolla Pjesë të përzgjedhura nga autorë si K. Gibran, S. Benni, A. Baricco, C. Churchill, Pessoa, G. Leopardi, që u sollën në një formë moderne dhe konceptuale nga të rinjtë. 17 Qershor 2025 3. “Emigrantët” – Sławomir Mrożek, Shkolla: Gjimnazi “Jordan Misja” Regjia: Simon Shkreli Aktorë: Ebis Artunda, Arbër Vata Një dramë sociale që trajton tematikat e identitetit dhe mërgimit, interpretuar me intensitet dhe ndjeshmëri nga nxënësit aktorë. 18 Qershor 2025 4. “Të jetosh në dashuri” – T. A. Baylan Ora: 18:00 Shkolla: Shkolla e Mesme “28 Nëntori” Regjia: Rajmonda Marku Aktorë: Ajsi Beqiri, Iris Hoxha, Arlind Shehu, Orgen Osja, Evra Efovija, Parid Kalaj, Julia Capa, Enes Balla, Enea Ymeri. 19 Qershor 2025. “Jo të gjithë hajdutët vijnë për keq” – Dario Fo Ora: 18:00 Shkolla: Shkolla Artistike “Prenkë Jakova” Regjia dhe adaptimi: Aleksandër Prenga Aktorë: Gabriel Rraposhi, Ariana Mhillaj, Denis Fikaj, Gresilda Guri, Dorotea Larushku, Eldis Miruku, Një komedi plot ritëm, që solli përmes satirës realitete shoqërore me humor inteligjent dhe mjeshtëri skenike. Juria e “Festivali Teatror i Shkollave te Mesme” ishte e përbërë nga : Zija Vukaj, Mirjam Bruçeti, Gëzim Puka dhe Krist Lleshi, të cilët vlerësuan me këto çmime këtë edicion.

4. Në skenën e Teatrit “Migjeni” u zhvillua premiera e shfaqjes “Kopshtet e pavarura të lumturisë”, me autor Albri Brahusha dhe regji të Hervin Çulit. Në themel të kësaj shfaqjeje qëndron penë e ndjeshme e autorit Albri Brahusha, i cili ka ditur të përziejë me mjeshtëri ironinë, reflektimin dhe emocionin njerëzor në një tekst që flet me gjuhën e sotme.

5. Miqte e Pyllit - Më datë 15-16 nëntor, në skenën e Teatrit “Migjeni” u zhvillua shfaqja për fëmijë “Miqtë e Pyllit”, një prodhim i mbështetur nga Bashkia Shkodër dhe projekti Dimension Human, me tekst nga Dajana Nenaj dhe regji nga Nikolin Ferketa.

6. Djali i detit - Në ambientet e Teatrit “Migjeni” në Shkodër, u vu në skenë shfaqja për fëmijë. Shfaqja u realizua nën regjinë e Anxhelo Shkrelit dhe u ndërtua si një rrëfim i ndjeshëm e njëkohësisht argëtues, ku fëmijët u udhëhoqën drejt botës së ëndrrave, miqësisë dhe besimit në magjinë e së mires

7. Aktiviteti “Shfaqje me humor dhe muzike”, i organizuar nga Teatri Migjeni është një shfaqje që mirëpritet nga spekatori. Humori dhe muzika janë dy nga simbolet e qytetit të Shkodrës. Kjo shfaqje bëri të mundur përfshirjen e aktorëve të rinj, të aktorëve të karrierës, të këngëtarëve më në zë, si dhe të orkestrës së Teatrit “Migjeni”.

Investime: P08220.Q1.O3.A27 Instalimi i sistemit të kondicinimit Teatri Migjeni-

Realizimi I aktiviteteve per kater mujorin e pare 2026:

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Relacioni-permbledhes-Programe-Monitorimi-4-M-2026.pdf

P.AF141.Q2.O3.A16 Festivali Mbarëkombëtar i Humorit në Shkodër e të trashëguara Nuk është realizuar sepse eshte planifikuar ne muajt ne vijim.Eshte ne proces prokurimi procedura Akomodim e Trajtim ushqimor.

-Teatri "Migjeni" organizoi "Festivali Teatror i Shkollave te Mesme" 2026.U realizua me sukses per 8 nete rradhazi ky festival si nje ure lidhese midis artisteve dhe te rinjve,duke perfshire 8 gjimnaze te qytetit te Shkodres. Pas pergatitjeve te gjata dhe provave intensive, shfaqjet u prezantuan per publikun me date 02 Mars deri me 09 Mars 2026. Shfaqja hapese e gjimnazit "Maarif"me titull "Tragjedist Pahiri". Nata e dyte e festivalit 3 Mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "Shejnaze Juka" me titull "Zoti I Masakres". Nata e trete e festivalit 4 Mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "Oso Kuka" me titull "Limona nga te Siçilise". Nata e katert e festivalit 5 Mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "Maria" m titull "Ajo iku". Nata e peste e festivalit 6 Mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "Prenke Jakova" me titull "Te gjithe me huqe". Nata e gjashte e festivalit 7 Mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "28 Nentori" me titull "Qeshu Rini". Nata e shtate e festivalit 8 mars 2026, ora 17:00: Shfaqja nga gjimnazi "At Gjon Karma" me titull "Martesa e shumepritur". Nata e tete e festivalit 9 Mars 2026, ora 11:00: Shfaqja nga gjimnazi "Jordan Misja" me titull "Darka e fundit". Vleresimi I performancave u realizua nga nje juri e perbere nga specialiste te fushes si :Todin Kasemi,Gjovalin Kolaj,Elsavet Alija,Vitmir Alikokej.Gjithashtu pervec stafit te teatrit jane angazhuar dhe regjisore te tjere si : Arben Haveri,Markerit Hilaj dhe Zef Ndoja.

-Ne teatrin Migjeni Shkoder u realizua me sukses shfaqja teatrore "Pese fytyrat e heshtjes", me regji te Ilir Bokshit.Premiera e kesaj shfaqjeje u mbjat ne datat 21 dhe 22 Mars 2026 ora 19:00, duke terhequr nje audience te interesuar dhe te angazhuar. Shfaqja u konceptua si nje rrefim bashkekohor qe trajtonte temen e heshtjes si fenomen psikologjik dhe social, duke depertuar ne perjetimet e brendshme te individit dhe tensionaet qe burojne nga marredheniet njerezore. Ne kete produksion moren pjese: Adrian Morina, Albulena Bokshi,Ina Morinaj,Urate Shabani,Nikolin Ferketa dhe Fritz Selmani. Nje element I rendesishem I kesaj shfaqjeje ishte dhe bashkepunimi me artiste nga Kosova, i cili I dha projektit nje dimension me te gjere kulturor dhe artistik.

Ne muajt ne vijim do kete dhe aktivitete te tjera per tu realizuar sipas dhe planifikimit. Aktualisht po shfaqet "Premiere me Humor dhe Muzike" dhe do te vijoje me Festivalin Kombetar te Humor, Pjese Teatrore 3, Shfaqje per femije.